




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644 – 18 – 8475 – 1-2-1/C145
14 Nr. 1263/18
Dt. 06.12.2018

KONTRATË FURNIZIMI

Palët kontraktuese:

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson: **Saranda Cakaj** – Drejtoreshë për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejshëm **Porositësi**), dhe
2. “ **Contanti Generators** “sh.p.k. me seli në **Fushë Kosovë**, me NRB : **70032976** e Nr. Fiskal: **600011085**, të cilën e përfaqëson **z. Xhevdet Beqiri**, në tekstin e mëtejshëm: **Furnizuesi**

, janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike kornizë, për furnizime dhe/ ose shërbime, si vijon:

Furnizimi me gjenerator dhe pajisje përcjellëse për objektin e ri të komunës , me numër identifikues:

Prokurimi Nr.	VU644	1	8	84	7	5	1	2	1
Prokurimi Nr.	644	1	8	2	1	8	1	2	1

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe shërbimeve nga ana e Kontraktuesit, si vijon :
Furnizimi me gjenerator dhe pajisje përcjellëse për objektin e ri të komunës , sipas dokumentacionit standard dhe Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues : 644-18-218-121.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

- 2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë: **10 (dhjetë) ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.**
- 2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë: **objekti i ri i Komunës së Vushtrrisë, sipas procedurës, si vijon : Inspektimi i cilësisë së gjeneratorit dhe pajisjeve shtesë do të bëhet nga Komisionit të Pranimit të Mallit, i emëruar nga ana e Zyrtarit Kryesor Administrativ të Autoritetit Kontraktues. Asnjë furnizim i mallit respektivisht asnjë ekzekutim i shërbimeve nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet cilësia dhe sasia e furnizimeve, nga ana e Komisionit të Pranimit të Mallit.**
- 2.3 Furnizuesi merr për obligim dhe pajtohet që gjeneratorin së bashku me pajisjet shtesë ta dërgoi dhe montoi në pajtim me kërkesat dhe specifikat teknike të saktësuar si në Dosjen e Tenderit, në vendin e caktuar të hapësirës në objektin e ri të komunës në Vushtrri. Njëherit Furnizuesi merr për obligim që personelin kompetent të caktuar nga Njësia e Kërkesës – Drejtoria Komunale për Administratë të Autoritetit

Kontraktues, ti ofroi shërbime të aftësimit dhe informimit të mjaftueshme lidhur me mënyrën e përdorimit dhe funksionimin e gjeneratorit të pranuar.

2.4. Në rast se Shitësi dështon në përmbushjen me kohë të detyrimit si në paragrafin paraprak të këtij neni, Blerësi mbanë të drejtën që për secilën ditë në vonesë të Shitësit, të zbatoj penale me 0,25% të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara, deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës, në çdo ditë të vonesës.

2.5 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

2.6 Garancioni për cilësinë e automjetit do të jetë përgjegjësi e Furnizuesit. Afati i garancionit fillon nga data e pranim – dorëzimit të automjetit dhe përfundon në një afat prej minimum 24 muajve, sipas kushteve të dhëna në ofertë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: **20.285,00 € (njëzetmijdyqindtëdhjetepesë/00€)**.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër është i prerë, nuk do ti nënshtrohet ndryshimeve dhe, është e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

3.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës, respektivisht pas Pranim të pajisjeve nga ana e Komisionit për Pranim të Mallit të Autoritetit Kontraktues.

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
- (f) Plani për menaxhimin e kontratës;
- (g) Procesverbali i mbledhjes së informatave/vizitës së vendit
- (h) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.


Për Autoritetin Kontraktues:

Emri:	Saranda Cakaj
Pozita:	Drejtoreshë për Prokurim Publik
Nënshkrimi:	
Data:	06.12.2018
Vula:	



Për Kontraktuesin - Furnizuesin:

Emri:	Xhevdet Beqiri
Pozita:	Përfaqësues i "Contanti Generators" sh.p.k. – Sllatinë/ K. Fushë Kosovë
Nënshkrimi:	
Data:	06.12.2018
Vula:	



² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolona E, ku duhet shkruar çmimi me dy decimale pas presjes dhjetore

Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi DDP-€	Totali - €
1	Gjenerator me kapacitet 300 KVA	copë	1	19350.00	19,350.00
2	ATS me tre konektor , kapacitet 400A	copë	1	935.00	935.00
TOTALI I PËRGJITHSHËM :					20,285.00

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	CONTANTI GENERATORS SH.P.K
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:	XHEVDET BEQIRI
NËNSHKRIMI:	
DATA:	23.11.2018
VULA:	

Handwritten signature

XH. B